



Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti



Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Drejtoria për Urbanizëm dhe Planifikim Hapësinor
Nr: 04-351-143106
Dt. 23.08.2016

DREJTORATI PËR URBANIZËM dhe PLANIFIKIM HAPËSINOR, me kërkesën e **Taner Igxhiler, Semahat Igciler dhe Fahire Igciler** nga **Prizreni** me banim në rrugën **“Xhemil Fluku”** në bazë të neneve 3-1.7 , 1.17. dhe të nenit 14.1.1 si dhe në lidhje me nenin 15 1.1 dhe nenit 19. pika 2. të Ligjit për ndërtim nr.04/L-110, dhe në harmoni me dispozitat e Ligjit për Qendrën Historike të Prizrenit nr.04/L-066 ,si dhe nenit 85 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale dhe të nenit 82. e në lidhje me nenin 84. LPA-së nr. 02/L-28, merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. **I LEJOHET: Taner Igxhiler, Semahat dhe Fahire Igciler** ndërtimi i objektit - **Shtëpi individuale me lokal afarist** në Prizren në vendin e ashtuquajtur / rrugën **“Xhemil Fluku” nr. 122/52** në ngastrën kadastrale e cila është e identifikuar në Aktin mbi kushtet për rregullimin e hapësirës nr. **04-353-31357** si dhe me Aktvendimin mbi lokacionin e objektit, sipas dokumentacionit teknik e cila është e hartuar nga ana e **“N.SH.” Archange”**.
- II. Dokumentacioni Teknik e mbanë titullin e tipit **veçantë**.
- III. Paralogaria e vlerës së objektit sipas këtij dokumentacioni teknik është në shumën prej **79.647,04 €**.
- IV. Ndërtimi i objekteve ndihmëse s’është e lejuar si dhe vlera e këtyre objekteve, është përjashtuar nga paralogaria e vlerës së objektit.
- V. Ditën e fillimit të punimeve investitori është i obliguar që të lajmërojë me shkrim organin kompetent (inspektionin e ndërtimtarisë) në afat prej 8ditësh.
- VI. Pas përfundimit të ndërtimit të objektit investitori duhet të parashtrojë kërkesë për marrjen e lejes për përdorim.
- VII. Ky aktvendim pushon të vlejë në rast se investitori me punë nuk fillon brenda afatit prej 12 (dymbëdhjet) muajsh duke llogaritur nga dita e lëshimit të lejes së ndërtimit.
- VIII. Kunjzërimi i objektit, si dhe nivelizimi i themeleve të bëhet sipas kushteve ndërtimore si dhe dimensioneve të skicuara në kopjen e planit të lëshuar nga kjo Drejtori, të njëjtit të vërtetuar në aktin mbi kushtet e rregullimit të hapësirës
- IX. Pronarët e pronave fqinje kanë të drejtë të marrin pjesë në procedurën e dhënies së lejes së ndërtimit (shikimin e dokumentacionit).
- X. Investitori është i obliguar të bëjë mbrojtjen dhe sigurinë në punishte dhe është përgjegjës dhe obligohet që gjitha dëmtimet e mundshme të rrjetit të ujësjellësit ,kanalizimit, PTK, KEDS-it, dhe avari tjera ti evitoj dhe ti kthej në gjendje të mëparshme me shpenzimet të veta dhe pa të drejtë kompensimi

.../...

Arsy et im

Parashtruesi i kërkesës: Taner Igxhiler, Semahat dhe Fahire Igçiler nga Prizreni me banim në rrugën “Xhemil Fluku ” nr.122/52 i është drejtuar këtij organi për marrjen e lejes së ndërtimit për ndërtim të objektit - Shtëpi individuale me lokal afarist.

Duke shfletuar dokumentacionin teknik si dhe të shtojcave tjera të prezantuara këtij organi s’bashku me kërkesë vërtetohet se:

Që me procedurën paraprake është kontrolluar dokumentacioni teknik nga ana e bashkëpunëtorit profesional.

Që parashtruesi i kërkesës ka miratuar të gjitha pagesat rreth ndërtimit të objektit si dhe s’bashku me kërkesë në shtojcë ka parashtruar këto dokumente të duhura: kopjen e planit, listën poseduese, pëlqimet e kërkuara të parashtruara , Aktvendimin mbi lokacionin, si dhe projektet.

Duke shqyrtuar kërkesën e investitorit si dhe në kuptim të dispozitave të Ligjit mbi ndërtim e të Rregullores mbi rregullat dhe procedurat për ndërtimin e objekteve është konstatuar se janë plotësuar kushtet për dhënien e lejes së ndërtimit.


Nga se u tha më lartë u muarr aktvendimi si në dispozitiv.

KËSHILLA UDHËZUESE JURIDIKE; Kundër këtij Aktvendimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 30/ditësh nga dita e marjes së të njëjtës Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor në Prishtinë, përmes këtij organi.

Ankesa taksohet me 0.50 Euro taksa administrative.

Hartuan

Bashkëpunëtorët profesional:


Xhejlane Gjini, inxh.dipl.ark.


Arben Shala, jur.dipl.

Kontrolloi:


Afërdita Mormorina, inxhi.dipl.ark.

